

HASAN KALESHI DHE KONTRIBUTI I TIJ PËR ORIGJINËN E FJALËVE TURKE NË GJUHËT BALLKANIKE ME THEKS TË VEÇANTË NË GJUHËN SHQIPE

Naile Mala IMAMI¹, Marija HRKALOVIC²

*1 Fakulteti Filologjik në Beograd
naile.malja.imami@fil.bg.ac.rs*

*2 Fakulteti Filologjik në Beograd
marija.hrkalovic@fil.bg.ac.rs*

Përmbledhje

Duke depërtuar në Ballkan në fund të shek. XIV dhe në fillim të shekullit XV dhe duke i pushtuar vendet ballkanike njëherë pas tjetrës me radhë, turqit e sollën me vete religjionin, rregullimin e ri shoqëror dhe shtetëror, institucionet e reja, kulturën e re orientale dhe, në fund një gjuhë të re. Jeta gati pesëqind vjeçare e disa popujve të Ballkanit nën Osmanët ka lënë gjurmë të dukshme në të gjitha aspektet materiale dhe shpirtërore të jetës së popujve ballkanikë. Mirëpo, ai ndikim nuk është i madh në asnjë fushë aq sa është ndikimi në gjuhë. Administrata e re me zyrtarë turq, me institucione të reja kulturore-arsimore dhe sociale, kontaktet e përhershme të popullsisë me pushtete, popullimi i disa viseve me turq dhe turqizimi i disa grupeve etnike, stacionimi i ushtrisë turke në qytete të mëdha dhe në kështjella, veprimtaria e përbashkët luftarake me turqit jo vetëm me myslimanë por edhe me disa kategori të tjera të krishterëve, marrja e fesë islame dhe me të edhe e terminologjisë fetare, shkollimi në shkollat turke ku është mësuar gjuha arabe, persiane dhe turke, predikimi me një numër të madh fjalësh në këto gjuhë, ndikimi i çarshisë që ka marrë karakter oriental, zejet e reja të cilat i kanë sjellë turqit, dhe, me ta, terminologjia e tërësishme zejtare etj., kanë ndikuar që huazimet orientale, përkatësisht turqizmat që kanë hyrë në çdo gjuhë ballkanike të jenë me disa mijëra. Nga ky numër i madh vetëm një pjesë e vogël, kryesisht termat e qytetërimit, ka hyrë përmes gjuhëve evropiane, si p.sh., *alkool, tarifa, avaria, admiral, almanak, zenit, azimut, kalif, kediv* etj.¹ kurse të tjerat, gjithsesi mbi 95 për qind, përmes gjuhës turke, pa e marrë parasysh faktin a bëhet fjalë për fjalë arabe, persiane ose fjalë të tjera orientale, por edhe një pjesë e atyre greke². (Kaleshi, 1970: 165).

Fjalë kyçe: shqipja, turqishtja, arabishtja, persishtja, gjuhët ballkanike, emrat, mbiemrat, foljet

¹ Nuk ka dyshim që fjala *kadif*, ka hyrë përmes turqishtes, por janë paraqitur edhe si *halif* dhe *kalif*, ose *kediv* – *hidiv*. Është interesant që Abdullah Shkaliqi, në veprën e vet *Turqizmat në gjuhën serbokroate* (Svjetlost, Sarajevo, 1965) nuk e ka përmendur as në parathënie këtë grup të huazimeve orientale, kështu që ka ndodhur që shumë prej tyre nuk e kanë gjetur vendin e vet në fjalorin e tij. Në këtë punim Kaleshi i ka shënuar vetëm disa fjalë për të cilat dihet se rrjedhin nga arabishtja dhe persishtja: *kanfor, tambura, naranda, azuran, limun, kadifa, soda, talk, abonos, nišador, amalgam, eliksir, baldahin, karat, kalibar, široko/gjerësisht (era), katran, alkali, antimonium, sirup, harader, kalup, dud, arsenik* etj. (Shih më gjerësisht Giovan Battista Pellegrini, *L'elemento arabo nelle lingue neolatine con particolare riguardo all'Italia*, in: *L'occidente e l'Islam nell'alto Medico evo*, t. II. Spoleto, 1965, 598/790).

² M. Vasmer në punimin e vet të njohur *Die griechischen Lehnwörter im Serbo-Kroatischen*, Berlin, 1944, ua ka kushtuar një kapitull fjalëve greke të cilat përmes turqishtes kanë hyrë në serbisht. Këto fjalë gjithashtu i gjejmë në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Qëllimi i punimit

Në këtë punim do të japim një biografi të shkurtër të dr. Hasan Kaleshit, pa u thelluar shumë në bibliografinë e tij të pasur. Ne do të merremi me punimin e tij *Ndikimet e gjuhës turke në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, i cili është botuar në Përmbledhjen e Fakultetit Filozofik në Prishtinë, Libri VII (për vitin 1970). Gjithashtu do të japim edhe disa shembuj për ndikimin e turqishtes në formimin e fjalëve të gjuhëve ballkanike. Kaleshi trajton çështje të shumta gramatikore, por ne në këtë punim do të merremi vetëm me formimin e emrave, mbiemrave dhe foljeve, të cilat janë formuar kryesisht me anë të prapashtesave të gjuhës turke. Nuk do të merremi me fjalët që kanë hyrë nga arabishtja dhe persishtja në gjuhën shqipe por vetëm aty-këtu do të japim ndonjë shembull, për të qartësuar më mirë kuptimin. Duke u bazuar në punimin e Kaleshit, do të përpiqemi të konstatojmë si dhe në çfarë mënyre janë krijuar fjalët në gjuhën shqipe nga fjalët turke por në disa raste do të japim ndonjë shembull edhe për gjuhët ballkanike. Për fjalët që janë më të ndërlikuara i kemi dhënë edhe referencat e literaturës dhe i kemi ilustruar me më shumë shembuj. Gjithashtu, përkthimin e fjalëve nga turqishtja në gjuhën shqipe e kemi dhënë me shkronja kursive.

1. Biografia dhe autobiografia e shkurtër e Hasan Kaleshit

Hasan Kaleshi lindi në fshatin Sërbicë të Kërçovës më 7 mars 1922. Mësimet e para i mori nga i ati Myderris Adem efendiu. Më pas ndoqi medresenë "Mbreti Aleksandër" në Shkup dhe dy klasë në shkollën e mesme "Sami Frashëri" në Prishtinë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore punoi si përkthyes. Pastaj u regjistrua në degën e orientalistikës në Fakultetin Filozofik të Beogradit. Nga viti 1947 deri më 1950 ishte përkthyes dhe lektor i gjuhës shqipe në redaksinë e Radio Beogradit. Më vonë punoi si mësues gjimnazi dhe bashkëpunëtor në Katedrën e orientalistikës në Universitetin e Beogradit.

Në vitin 1951 diplomoi në Degën e Orientalistikës në Universitetin e Beogradit me temën e doktoratës: *Dokumentet më të vjetra të vakëfeve të Jugosllavisë në gjuhën arabe*. Më 1952 u caktua lektor i filologjisë orientale dhe më 1960 botoi studimin e tij i cili ishte botimi i tezës së doktoratës. Në fund të viteve '50 u angazhua për përgatitjen e fjalorit të madh serbokroatisht-arabisht, e disa herë gjatë viteve '60 punoi edhe si përkthyes për serbokroatisht-arabisht. Në vitin 1965 Kaleshi shkoi në Institutin Ural-Altaik të Universitetit të Hamburgut që të studiojë turkologjinë. Në fund të viteve '60 u zgjodh bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin e Albanologjisë në Prishtinë si njohës i mirë i gjuhëve orientale, e më pas profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ndërroi jetë në moshën 54-vjeçare, në vitin 1976.

Kaleshi ishte një ndër albanologët, ballkanologët dhe turkologët e shquar të asaj kohe. Përveç gjuhës amtare ai e fliste gjuhën maqedonase, turke, serbe, arabe, gjermane, angleze, frënge, italiane, të cilat ia mundësuan që të merrej seriozisht me tema të shumta në fushën e gjuhësisë. Ai ka botuar një sërë studimesh në revista shkencore në të cilat i ka trajtuar çështjet e orientalistikës dhe ballkanistikës. Ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare për Orientalistikë. Në Egjipt ai pati fatin të takohet me shumë shkrimtarë të shquar të asaj kohe, të cilëve u ndihmoi, duke përkthyer pjesë nga veprat e tyre, si: Mahmud Tejmur, Teufik Al-Hakim etj.

Gjatë viteve '50 të shekullit të kaluar, Kaleshi shfaqti një interesim të veçantë për gjuhën shqipe. Studimin e tij të parë në gjuhën shqipe e publikoi në vitin 1949 me titull *Vërejtje rreth gjuhës së përdorur në gazetarinë tonë*. Më 1952 e botoi studimin: *Letërsia bashkëkohore shqipe*

në Jugosllavi. Në vitin 1957 botoi artikullin me temë *Letërsia e shkruar shqipe me shkrim arab*. Në vitin 1969 e botoi separatin *Sami Frashëri në letërsinë dhe filologjinë turke*, Gjurmime albanologjike, 1968. Po këtë vit e botoi edhe separatin *Disa aspekte të luftës për Alfabetin shqip në Stamboll*, Gjurmime albanologjike, 1969. *Fjalët e para turko-serbe, Shtypshkronjat dhe fillimet e botimit të librave në Kosovë*, (ekstraktin nga libri: “Fillimet e shtypjes së librave të popujve jugosllavë”) (Instituti Jugosllav për gazetari)³. Në vitin 1970, e botoi ekstraktin *Veprat turqisht dhe persisht të Naim Frashërit*, Gjurmime albanologjike, 1-2, 1970 dhe *Ndikimet e gjuhës turke në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Përmbledhja e Fakultetit Filologjik në Prishtinë. Ka përkthyer në gjuhë të ndryshme të rajonit një mori të veprave të shkrimtarëve arabë, si: Ibni Rumi, Xhubran Khalil Xhubran, Bulend El-Hajderi, Nizar Kabbani, Sulejman Al-Isa etj. Ka publikuar studime të veçanta në kuadër të letërsisë arabe, si: *Letërsia bashkëkohore egjiptiane*, 1956, *Risite në poezinë moderne arabe*, 1965. Ka përkthyer një seri tregimesh të shkrimtarit të njohur arab Mahmud Tejmur, si dhe ka përgatitur një tekst universitar që trajton *Historinë e letërsisë arabe*, të cilin ia propozoi Rektoratit të Universitetit të Kosovës, por ky dorëshkrim nuk u botua.⁴

Në kryeveprat e realizuara nga dr. Hasan Kaleshi, bën pjesë dhe *Fjalori serbokroatisht-arabisht*, të cilin e përfundoi me sukses në bashkëpunim me studiuesin e njohur Kamil El-Buhi, një ndër personalitetet më të njohura të fushës së Orientalistikës gjatë viteve ‘50. Fjalori doli nga shtypi pas ndarjes nga jeta e të dy autorëve. Ai përfshin rreth 50 mijë fjalë e idioma në të dyja gjuhët dhe pati ndikim të jashtëzakonshëm që brezat e rinj që e kishin gjuhë amtare serbokroatishten ta mësonin më lehtë arabishten.

2. Ndikimi i turqishtes në gjuhët ballkanike

Siç e dimë, jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në gjuhët ballkanike, një sërë fjalësh janë formuar nga fjalët turke ose me anë të prapashtesave të gjuhës turke. Në fillim do t’i japim shembujt e fjalëve në gjuhët ballkanike që janë formuar me anë të prapashtesës *-li*, *-luk*, *-xhi*, për të cilat shkroi Kaleshi: *fakultetlija*, *pubertetlija*, *apetitlija*, *režimlija*, *nestašluk*, *paganluk*, *siledžija*, *larmadžija* etj. Në gjuhën shqipe, *fakultetli*, *pubertetli*, *rexhimli*, *agallëk*, *arallëk*, *avashllëk*, *axhamillëk*, *baballëk*, *silexhi*, *larmanaxhi*, *akinxhi*, *abaxhi*, *arixhi*, *baxhoxhi*, *bejtexhi*, *birinxhi*, *bojaxhi*, *bostanxhi*, *dajrexhi*, *dallaverxhi*, *delenxhi*, *duhanxhi* etj. Sipas Kaleshit, studimi i turqizmeve në gjuhët ballkanike nuk është me rëndësi vetëm për filologët por edhe nga pikëpamja kulturo-historike dhe sociologjike. Pa njohjen e mirë të turqizmeve nuk mund të studiohen as letërsia popullore, etnologjia, historia, me një fjalë tërë jeta materiale dhe shpirtërore e popujve të Ballkanit.

Megjithatë, edhe krahas një rëndësie kaq të madhe, turqizmat në gjuhët ballkanike nuk janë studiuar sa duhet. Nuk është bërë as krahasimi kontrastiv i tyre në secilën gjuhë. Sipas Kaleshit studimet më të thelluara në këtë fushë janë bërë në gjuhën serbe. Ai theksoi se një interesim më të madh për këtë gjuhë e ka treguar para njëqind e sa vjetësh Otto Blau⁵, kurse seriozisht me këtë temë i pari u mor ballkanologu dhe albanologu i shquar F. Mikloshiq, dhe këtë duke i përfshirë të gjitha gjuhët ballkanike dhe gjuhët sllave. Plotësimet e Fridrich Kraelitzit dhe Theodor Korschit vetëm e kanë shtuar vlerën e punimit të Mikloshiqit. Pas tij, janë paraqitur

³ Dr Hasan Kaleši, Prve tursko-srpske štamparije i počeci štampe na Kosovu, (Separat iz Knjige „Počeci štampe jugoslovenskih naroda“) Jugoslovenski institut za Novinarstvo, Beograd, 1969.

⁴ ArkivaDokumente/photos/a.530456407062465/668770503231054/?type=3

⁵ Dr Otto Blau, *Bosnisch-türkische sprachdenkmäler*, Leipzig, 1868.

edhe disa punime, kurse më vonë edhe fjalori i Shkaliqit dhe ai i Antun Knezheviqit. Megjithatë, sipas Kaleshit një numër i vogël i gjuhëtarëve është marrë me ndikimin e turqizmeve në gjuhët ballkanike dhe në mesin e tyre e përmend një numër të vogël të punimeve por të cilat i vlerëson shumë të rëndësishme si për shembull punimet e Shmausit⁶, Kisslingut⁷, Stakovskut⁸, Hazaj⁹ dhe të tjerëve¹⁰. (Kaleshi, 1970: 166-167).

Për turqizmat në gjuhën rumune Kaleshi e përmend veprën klasike të L. Shaineaunut¹¹, kurse për gjuhën hungareze, krahas një sërë punimesh e përmend edhe duajenin e turkologjisë profesorin Nemeth¹², por edhe një sërë punimesh të S. Kakuk¹³-ut. Për ndikimin e turqishtes në gjuhën bullgare, Kaleshi e përmend gjuhëtarin B. Conev¹⁴, i cili shkroi një sërë punimesh, kurse për ndikimet e gjuhës turke në gjuhën maqedonase shkroi Olivera Jashar-Nasteva.¹⁵ (Kaleshi, 1970: 167).

3. Ndikimi i turqishtes në formimin e fjalëve të gjuhës shqipe

Sipas Kaleshit, studimin e ndikimeve orientale në gjuhën shqipe, pas Mikloshiqit, dhe një numri të turqizmeve të cilët i ka përfshirë G. Majer, në fjalorin e vet, ka shkruar shumë ngadalë, edhe pse, sipas tij, mund të pohohet se ndikimi i turqishtes në gjuhën shqipe është më i madh,

⁶ Alois Schmaus, *Zurt lautgestald der türkischen Lehnwörter in den südslawischen Sprachen*, Münchener Studien zur Sprachwissenschaft, Heft 6, 1955, (104-123); i njëjti: *Türkisch k'-g', ç-c in den Balkansprachen*, Slavist, Studien, München 1968, 170-182; i njëjti *Gramatički rod turskih imenica u južnoslovenskim jezicima*, Zbornik za filologiju i lingvistiku (Novi Sad) 4-5, 1961/2, 300-308; i njëjti: *Pojave tursko-srpskohrvatske jezičke interferencije*, Godišnjak VI, Centar za balkanološka ispitivanja, knj. 4, Sarajevo 1968.

⁷ H.J.Kissling, *Zu den Turcismen in den südslawischen Sprachen*, Zeitschrift für Balkanologie 1964.

⁸ Stanisllav Stachowski, *Studia nad chronologia, turcyzmow w jeziku serbsko-chorwackim*, Zeszyty Naukowe uniwersytetu, Jagiellonskiego CXLV, Prace językoznawcze, Zeszyty 18, Krakow 1967; i njëjti: *Przyczynek do chronologii turcyzmow w jeziku serbsko-chorwackim*, Nadbitka ze Studiow z filologii Polskiej i slowianskiej, T. VIII (1969), 303-309; i njëjti: *Die osmanisch-türkischen Lehnwörter im Serbokroatischen und ihre Bedeutung für die historische Phonetik des Osmanisch-türkischen*, Folia orientalia 4, (1962), 143-170.

⁹ G.Hazai, *Remarques sur les emprunts turcs des langues sud-slaves*, Slavica Academiae Scientiarum Hungaricae VII (1961), 97-138; i njëjti: *Kam njakoi vaprosi na osmansko-turskite zaemki v južnoslavjanskite ezici*, Studia Slavica Hung. IX (1963), 387-391.

¹⁰ V. nrp. Ismail Eren, *Güney islav (strp-Hrvat-Bulgar ve Makedon) dillerinde kulla-mulan Türkçe ekler*, XI Türk Dil Kurultayında okunan Bilmesel Bildirilerden Ayribasım, Ankara 1968; Snježana Velajčić, *Srp-Hrvat diline girmiş olan Türk maddi kültür unsurları*, Istanbul, Üniversitesi Edebiyat Fakültesi, Doctora Teezi, Istanbul, 1966.

¹¹ S. Şaineanu, *Influenta orientala asupra limbii, și culturei romane* I-II, București, 1910.

¹² Gy, Németh, *Traces of the Turkish Language In Albania*, Acta Orient. Hung. XIII (1961), 9-29; Stanisllav Stachowski, *Der türkisch Dialekt des XVII Jh, In Albanien*, Folia orientalia, Tome X (2957), 177-195; i njëjti: *Beiträge zur Chronologie der Albanischen, Turzismen*, Folia orientalia Tome (1969), 51-58; Anton Krajni, *Bref aperçu des emprunts turcs à l'albanais*. Studia albanica 2/70. 85-96.

¹³ S. Kakuk, *Les mots d'emprunt tures-osmanlis dans le hongrois et les recherches d'histoire phonétique del a langue turque osmanlie*, Acta Orient. Hung. Tomus V. Fasc. 3, dhe sidomos punimin e saj: *Die Südslawische Vermittlung bei den osmanisch-türkischen Lehnwörtern der ungarischen Sprache*, Actes du premier Congres international des etudes balkaniques et sud-est europeennes VI, Sofia 1968, 763-711, i cili është i rëndësishëm edhe për ne sepse tregon se si turqizmat përmes serbokroatishtes kanë kaluar edhe në hungarisht.

¹⁴ Prof. B. Conev, *Turski dumi v bulgarski ezik*, Godišnik na sofijskija univerzitet, Istorisko-filologičeski fakulet XXV, 4; Kiril Mirčev, *Za sudbata na turcizmit v bulgarski ezik*, Izvestija na Institutata za bulgarski ezik, knj. II (1952), 117-127.

¹⁵ O Jašar Nasteva, *Makedonskite kalki od turskiot jazik*, *Makedonski jazik* 13-4, 1962/3, 109-172; dhe *Tursko-makedonski leksički vkrstuvanja i mešanja*, Godišen zbornik na Fil. Fak. Na Univerzitetot vo Skopje, kn. 15 (1963), 349-384. (Kaleshi, 1970: 167).

dhe gjithsesi njëri nga ndikimet më interesante. Kaleshi e përmend edhe T.N. Dizdarin¹⁶, i cili në Fjalorin e huazimeve orientale ka përfshirë huazime interesante dhe që është i rëndësishëm për shkencën bashkëkohore. Po ashtu rëndësi të madhe i kushton edhe punimit të Aleksandar Xhuvanit dhe atij të Eqrem Çabejt për prapashtesat në gjuhën shqipe, ku i kanë përfshirë edhe disa prapashtesa të turqishtes¹⁷.

Kaleshi në këtë punim është marrë me tema të ndryshme, siç është ndikimi i turqishtes në formimin e gjuhës shqipe, duke përfshirë mbaresat gramatikore, shumësin, njëjësin, deminutivin, privativin e shumë e shumë tema të tjera morfologjike. Materialin e ka grumbulluar nga letërsia popullore dhe e shkruar, por edhe nga burimet e punimeve të botuara dhe nga shënimet e veta.

I. Formimi i emrave

Ndikimin e turqishtes në formimin e emrave Kaleshi e ka ndarë në tri kategori:

- 1) Formimi i emrave përmes prapashtesave të ndryshme, pa e marrë parasysh faktin a janë këto prapashtesa prodhimtare ose jo, përkatësisht a kanë hyrë bashkë me emrat e gjuhës turke në gjuhën shqipe;
- 2) Fjalët e përbëra, pa e marrë parasysh a janë krijuar në gjuhën shqipe ose si fjalë të përbëra kanë hyrë nga turqishtja (të trashëguara); dhe
- 3) Emrat e radhitur sipas lidhjes së gjinorese të turqishtes ose persishtes, edhe pse ato kanë ardhur nga turqishtja si tashmë fjalë të përbëra.

Kaleshi, u mor edhe me formimin e gjinisë femërore nga emrat në gjuhën turke, duke marrë parasysh se turqishtja nuk ka gjini gramatikore. (Kaleshi, 1970: 169).

1. *Mbaresa për formimin e shumësit -ler/lar*. Në gjuhën turke, shumësi formohet me mbaresat *-ler/-lar*, varësisht nga ligjet e harmonisë vokale. Për dallim nga serbokroatishtja ku ky formant nuk paraqitet, sepse njëjësit të emrave të gjuhës turke u shtohen mbaresat e serbokroatishtes, psh.: *aga-age*, (agai) *beg-begovi* (beu-bejlerë), *šejh-šejhovi*¹⁸ (kryeplak-kryepleq). Edhe pse në gjuhën shqipe ekziston një numër i konsiderueshëm i emrave të cilët e kanë formuar shumësin në këtë mënyrë: *mbret-lerë*, *dhespot-lerë*), sipas mendimit të Kaleshit kjo mbaresë në gjuhën shqipe nuk është e përhapur dhe që mbaresa *-ler/-lar*, ka hyrë bashkë me formën e shumësit. Se bashkë me formën e njëjësit ka hyrë edhe forma e shumësit dëshmon edhe fakti se, si edhe në turqisht, i gjejmë të dy formantet *-lar/-ler*, edhe pse në gjuhën shqipe për një gjë të tillë nuk ka arsye, sepse nuk vlejnjë rregullat e harmonisë vokale si në turqisht¹⁹.

Një gjë e tillë shihet më së miri nga shembujt që i jep Kaleshi: *at-llarë* (Gjëegjëza 114, KPSk 37), < tur. atlar < *usta-llarë* (K) ‘mjeshtër, ndërtues’ < ustalar; *shahllarë* (KPH 28) < şahlar; *çauhallarë* (KPH 6), ‘kapterë’ < çauşlar; *agallarë* (Asllani 44), < ağalar; *zabıllarë* ‘oficerët’ < zabıtlar; *hanëmlarë* (Imami 29) ‘hanume’ < hanımlar; *hoxhallarë* < hocalar. Por këtu, Kaleshi jep edhe disa shembuj që e kanë origjinën nga osmanishtja e vjetër, si psh., *beglerë* (Imami 67) edhe *bejlerë* (Asllani 68) < beyler; *dervishlerë* (Imami 37), < dervişler; *shehlerë* (Gjëegjëza 161), < şeyhler. Kaleshi shtoi se këto fjalë ende përdoreshin në dialektin e turqve të Prizrenit, kurse në dialektin toskë kjo

¹⁶ N.T.Dizdari, *Huazime orientalizmesh në shqipet*, Buletin i Univerzitetit shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat shoqërore, nga viti 1960, e më vonë në “Studime filologjike”.

¹⁷ Prapashtesat e gjuhës shqipe, nga prof. Dr. Aleksandër Xhuvani dhe prof. Eqrem Çabej, Tiranë, 1962.

¹⁸ Kaleshi pohon se vetëm në revistën *Stari srpski zapisi i natpisi* (III 5576) ka hasur në mbarsën *-lar* në një shënim nga viti 1730: *vzleze veir’že i proči agalari*.

¹⁹ Po aty.

- fjalë paraqitet në formën *bejlerë*. Si analogji, e thekson se në shumës fjala *kallaxhilerë* ‘kalugjeri’ < në greq. është kaloger. (1970: 170)
2. *Mbaresa -xhik, për deminutiv (trajtën zvogëluese)*: Sipas Kaleshit, mbaresa e gjuhës turke për deminutiv *-cik/cık/-cuk/-cük*; *-çik/-çuk/-çük* është shumë e rrallë në gjuhën shqipe dhe këtë vetëm me mbaresën *-xhik* (tur. *cik*). Ai në gjuhën shqipe i ka hasur vetëm disa fjalë me këtë mbaresë: *kapixhik* (Imami 13,57) < *kapıcık*; *hamamxhik* (banjo e vogël shtëpie) < *hamamcık*; *sakllamaxhik* (K-Podujevë), lojë fëmijësh, vend i fshehtë < tur. *saklamak*; *çelik xhik* (lojë fëmijësh) < *çelıcık*; *arpaxhik* < *arpacık*²⁰.
 3. *Formimi i emrave me prapashtesën -li*: Mbaresa e gjuhës turke *-li/lu*; */li/lü/* në gjuhën turke shërben për formimin e mbiemrave nga emrat por këta mbiemra përdoren edhe si të emëruar. Kuptimet janë mjaft të ndryshme. Kjo mbaresë në gjuhën shqipe është mjaft e shpeshtë – dhe kjo u shtohet emrave kur formojnë mbiemra nga të cilët disa kanë kuptim emëror²¹. Kuptimet themelore në gjuhën shqipe janë këto:
 - a) Për emërtimet e personave të cilët e kanë prejardhjen nga ndonjë shtet ose vend përkatësisht për emërtimet e banorëve të disa vendeve, qyteteve dhe vendeve, siç është rasti edhe me mbaresën *-li+ja* në gjuhën serbokroate, psh., *Stamboll-li*, *Prizrenli*, *Elbasanli*, *Sarajli*, *jerli* ‘vendas’ < *yerlü*; *sheherli* ‘qytetar, banor²² i qytetit’ < *şehirli*; *vendali* ‘banor’ < shq. *vend+a+li*, ndoshta është neologjizëm nga *yerlü*.
 - b) Emërton personat që kanë ose posedojnë ndonjë gjë: ‘izinli’ që ka leje për diçka, mungon me leje’ < *ızınli*; *mejtepli*, *meqtepli* dhe *mitepli* (KHP 147); *mejtepli* < *njeri i shkolluar, atlı* < që ka kalë, kalorës’ < *kafoxhakli* (Imami 79) ‘ai që ka oxhak për kafe, ai te i cili pihet kafeja gjithmonë’ < *kahve ocağı*; *zanatli* ‘zejtar, që ka një zeje’ < *sanatlı*; *myhyrli* ‘që mban vulë, ‘i dyllosur, i vulosur’ < *mühürlü*; *namusli* (K) ‘ai që ka nder, i ndershëm ‘namuslu; *merakli* ‘merakli, që do ndonjë gjë’ merakli; *hakli* ‘ai që ka të drejtë’ hakli; *çantali* (K) ‘ai që mban çantë, pejorative për nëpunës’ *çantali*; *kapakli* dhe *kapaklli* (KPH 52) ‘ai që ka kapak’ < *kapaklı*; *sevdalli* (Fj) ‘ai që ka sevda, d.m.th., që është i dashuruar’ < *sevđalı*; *kryqali* (Pren. 80) ‘ai që ka kryq, d.m.th., i kryqëzuar, i krishter’ < shq. *kryq+a+li*; *pullali* (PP III 524) ‘pikalosh, kalë pikalosh’ < shq. *pulla+li*. Në PP III, 204, Kaleshi e thekson edhe mbiemrin *Bajramli* (Bajramlli, o bir pse më bie erë njeriu) gjë që mund të jetë edhe emër vetjak. Si shembull të veçantë Kaleshi e thekson emrin *turçe-li* (Imami 96) (türk+çe+li ‘ai që flet turqisht, turk’, neologjizëm që nuk gjendet në gjuhën turke, sipas Kaleshit (1970: 170).
 4. *Formimi i emrave me prapashtesën -xhi, -çi*: Prapashtesat *-ci/-cu*; *-ci/-cü* (pas bashkëtingëlloreve f, p, ş, ç, k, h, s, t -çl/-çü) janë ndër prapashtesat më të përdorura në gjuhët ballkanike dhe më prodhimtare. Në gjuhën shqipe paraqiten si *-xhi dhe -çi*. Si *-xh* (tur. *-ci*) sipas Kaleshit u shtohen fjalëve të cilat përfundojnë me bashkëtingëllore të zëshme, ose me zanore, kurse si *-çi* bashkëtingëlloreve të pazëshme. Përafërsisht si në gjuhën turke. Kaleshi mendon se gjuhëtarët ballkanikë edhe pse kanë bërë përpjekje që t’u shmangen këtyre prapashtesave, këto megjithatë janë ruajtur dhe ende janë edhe më prodhimtare²³. Ai fjalët që formohen me këtë prapashtesë i ndan në tri kategori.

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

²² Po aty.

²³ Po aty.

- a) Fjalët të cilat kanë hyrë në gjuhën shqipe me prapashtesë: *zanatçi*, (Fj, Gjëegjëza 94), < *sanatçi*, por krahas kësaj mund të përdoret edhe *zanatli*; *sheqerxhi* (Fj, K) < *şekerci*; *shakaxhi* (Fj, Imami 35) < *şakaci*; *sehirxhi* (Fj. dhe sejrxi (K) < *seyirci*; *sazexhi* (Fj, PP I 229), < *sazci*; *samarxhi* < tur. *semerci* < greq. *sagmarion*; *qiraxhi* (Fj, Imami 96) dhe *qeraxhi* (Pren. 130) < *kiraci*, etj. (Kaleshi, 1970: 171).
- b) Fjalët e gjuhës turke të cilave u janë shtuar prapashtesat *-xhi*, *-çi* në gjuhën shqipe, sepse turqishtja nuk ka neologjizma të tillë: *telallxhi* (Çetta 122) por edhe *telall-i* < tur. *tellal*, arab. *dellâl*; *xhelatxhi* (Çetta 39, 160, 112) < *cellat*; *bahçevanxhi* (PP IV 103), por gjithashtu edhe *bahçevan* < tur. *bahçevan*; *kasapçi* (K-Podujevë) < tur. *kasab* < arab. *qassâb*, por gjithashtu edhe *kasap*. etj.
- c) Fjalët e gjuhës shqipe ose fjalët me origjinë të gjuhëve europiane, të cilat formohen me prapashtesën *-xhi* dhe që e kanë kuptimin e punëtorit, *nomen actoris*: (PP I 98), Gjëegjëza 531) dhe *mullixhi* < shq. *mulli*; *shalaxhi* (Fj) < shq. *shala*; *vorraxhi* (Imami 84) *vordraxhi* (fj.) < shq. *vorr*; *lodraxhi* (Gjëegjëza 224) < shq. *lodër*; *gëlqerexhi* (Fj.) dhe *këlçerexhi* (K) < shq. *gëlqere*; *barkaxhi* (Fj, Pren. 110) < shq. *barkë* < alb it. *Barca*; *mollaxhi* (Pren. 48) < shq. *molla*; *dardhaxhi* (Pren. 148) < shq. *dardha*; *pemaxhi* (Fj), pemë²⁴, dhe etj.
- Një numër i këtyre fjalëve, në radhë të parë tregojnë profesione, nga emërtimet e të cilave u formuan mbiemrat si psh., *Mumxhiu*, *Duhanxhiu* dhe me prapashtesën *-çi*, *Biçakçiu*.
5. *Formimi i emrave me prapashtesën -llëk*. Prapashtesat *-lik/lık*; *-lük/-luk* të gjuhës turke janë prapashtesat më të shpeshta të gjuhës turke që kanë hyrë në të gjitha gjuhët ballkanike. Në gjuhën shqipe ka hyrë shumë herët, dhe këtë prapashtesë e gjejmë edhe te P. Bogdani (*Cuneus Praphetarum* I 36, 119 –). Këto prapashtesa Kaleshi i përmend duke u bazuar në veprën e Xhuvanit dhe të Çabejt. Në fjalët *perëndillëk* < shq. *perendi*, *zot*, it. ‘*imperio*’. Kaleshi thekson se në gjuhën shqipe paraqitet në formën *-llëk* dhe këtë në rreth 90% të rasteve, si psh.:
- prapashtesa *llak*: *dyshekllak* (Çetta 52); *harçllak* (Çeta 187, 135), *zotshpillak* (Çetta 137).
 - *llyk* (*lük*): *pashallyk* (Çetta 52).
 - *lluk*: *rahatlluk* (Imami 55), *selamlluk* (PP IV 607);
 - *llug*: *synetllug* (PP IV 600).
 - *llek*: *gazepllek* (KPS 141), *horllek* (KPH 108); *njerzillek* (KPSk 204);
 - *llik*: *shenllik* (PP III 249), *çinarallik* (PP IV 600)²⁵

Fjalët e krijuara me prapashtesën *-llëk*, Kaleshi i ndan në dy grupe:

Në grupin e parë ku fjalët turke kanë hyrë në gjuhën shqipe si të gatshme bashkë me këtë prapashtesë: *ahmakllëk*, *amurllëk*, *hasretllëk*, *haxhikllëk*, *selamllëk*, *begllëk*, *dynjallëk*, *pabesillëk*, *qerratallëk*, *zabitllëk*, *hoxhallëk*, *bahçallëk*, *batakçillëk*, *axhamillëk*, *shejtanllëk*, *mullallëk*, *zezjginëllëk*, *tuxharllëk*, *matufllëk*, *budallallëk*, *dembellëk* etj.

Në grupin e dytë hyjnë fjalët e formuara me prapashtesën *-llëk*: *horrllëk* dhe *horrllëk*, *mbretllëk*, *avokatëllëk*, *zotshpillak*, *njerzillëk*, *evgjitllëk*, *fshatarllëk*, *pleqërrillëk*, *sëmundllëk*, *zotnillëk*, *nikoqirllëk*, etj.

Nga shembujt e dhënë mund të konstatojmë se disa fjalë janë formuar nga emrat në gjuhën turke si për shembull *haxhillëk* < *haci*; *pashallëk* < *paşa*; Disa emra janë formuar nga emrat në gjuhën

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

shqipe, si *njerzillëk* < shq. njerëz; *fshatar-llëk* < fshatar. Disa nga mbiemrat në gjuhën turke; *budallallëk* < tur. budalla ‘i marrë’ *ahmakllëk* < tur. ahmak ‘mendjeplogët, i mefshtë’ (Kaleshi, 1970: 175).

Siç e pamë fjalët e formuara me prapashtesën llë janë formuar:

- 1) nga emrat në gjuhën turke, dhe numri i tyre është më i madh, si *haxhillëk* *haxhillëk* < haxi; *pashallëk* < paşa
 - 2) nga emrat në gjuhën shqipe, si *njerzillëk* < shq. njerëz; *fshatarllëk* < shq. fshatar;
 - 3) nga mbiemrat e fjalëve turke: *budallallëk* < tur. budalla, *ahamkllëk* < tur. ahmak;
 - 4) nga mbiemrat e gjuhës shqipe: *sëmundëllëk* < shq. sëmundë; *pabesëllëk* < shq. (i,e,të) pabesë;
 - 5) Nga privativët e gjuhës turke: *horsëzllëk* < hirsız; *edepsëzllëk*;
 - 6) Nga emrat që tregojnë emërtime profesionale, dhe mbarojnë me mbaresat *-xhi*, *-çi*: < *saatchillëk* < saatçi, *kundraxhillëk* < kunduraci; (Kaleshi, 1970: 176)
6. *Formimi i emrave prejëmërorë me prapashtesa të gjuhës shqipe*: Disa emra janë formuar nga emrat e gjuhës turke dhe me prapashtesën e gjuhës shqipe. Prapashtesa më e shpeshtë është *-i* me të cilën formohen emrat abstraktë dhe përmbledhës: *beqaria* (Pren. 148) < tur. bekâr; *argati* < tur. ırgat; *hajni* (Fj. PP I 228) < hain; *shejtani* (Fj) < tur. şeytan; *rahat* (Fj, KPH 157) < rahat, etj.;... (Kaleshi, 1970: 180)

7. *Formimi i emrave të gjinisë femërore*: Dihet që turqishtja nuk e ka kategorinë e gjinisë. Kaleshi në këtë punim u mor me këtë kategori dhe konstatoi se emrat që kanë hyrë në gjuhën shqipe e formojnë gjininë femërore sipas mbaresave të cilat vlejné edhe për emrat e gjuhës shqipe.

Sipas Kaleshit, emrat e gjinisë femërore formohen me mbaresën *-e*: *jetim-e* (Çetta 35), *yetim*; *sulltan-e* < sulltan; (Pren. 149); *teveqel-e* (PP I 262) – mbiemër i substantivuar në kuptimin ‘e krisur’ < tevekkel; *çoban-e* (Fj), *muslimane* < müslüman, *xhine* (PP III 214 – *Mor ‘Aman ç’ je ti xhinë je apo peri’ “xhinka”* < arab. Tur. cin; *dervişe* (PP II 203) < derviş (grua dervishë); *hamile* (PP IV 602) ‘grua shtatzanë’ < arab. tur. hâmile ili hâmile; *byrazere* (motër), < birader.

Me mbaresën *-e* formohen edhe disa mbiemra të gjuhës turke, që mund të përdoren edhe si substantivë: *jallane* (Imami 68) ‘i rremë, artificialë’ tur. < yalan; *zavalli*, (fj.) ‘i mjerë, i shkretë’ < zavallı.

Me mbaresën *-eshë*: *jaraneshë* (Çetta 16, 113, Pren. 145) ‘mikeshë’ < yaran; *turkeshë* (Pren. 12) ‘turke’ < turk; *sojleshë* (fj.) ‘nga shtëpia e mirë’ < soylu; *pasheshë* (PP I 227) dhe *pashalleshë* (Asllani 25), ‘gruaja e pashës’ < paşa; *hajneshë* ‘vjedhëse’ < hain; *çobaneshë* (fj.) < çoban; *arapeshë* (Gjëegjëza 159) < arab. *ageshë* (fj.) < ağa.

Sipas Kaleshit, ndikimi i mbaresave të gjuhëve sllave për formimin e gjinisë femërore është i konsiderueshëm në gjuhën shqipe. Disa prej këtyre mbaresave janë përdorur për formimin e emrave të gjinisë femërore në gjuhën shqipe:

- a) Mbaresën *-kë* (sllav. *ka*: *tenxher-kë* (>Gjëegjëza 337, Çetta 87) ‘lonac’ < tencere, kurse në shqip në Kërçovë tenxhere; *hanxhar-kë* (PP I 360, Çetta 87) ‘nož’ < hançer; *arapkë* ‘arapkinja’ < araç/; *çobankë* ‘çobanica’ çoban; *llafazan-kë* (Asllani 24) ‘brbljivica’ < llafazan; *hysmeqar-kë* (PP I 183, 219) sluşkinja’ < hizmetkâr; *shejtan-kë* ‘đavolica’, ‘shejtane’ < şeytan; *arshin-kë* (PP III 872) ‘arşin’ < arşin; *byrazer-kë* (PP III 572) krahas *byrazere* ‘sestra’ < birader; *haxhush-kë* (Çetta 101, 113) ‘stara zla

žena' < tur. acuze < arab. 'ağuz'; *allat-kë* 'alatka' < 'alat, e ndoshta edhe nga serbokr. alatka.

b) Mbaresën *-çkë* < (sllav.) ose ndoshta nga prapashtesa deminutive të gjuhës maqedonase *-ička: inxhi-çkë* (Gjëegjëza 338) 'margaritar i vogël, perlë' < inçi; *kutiçkë* (Gjëegjëza 337) 'kutijica' < kutu.

c) Mbaresën *-ki* dhe *kinë* (sllav. kinja) *at-ki* dhe *at-kinë* (Fj.) (Pren 5,17, Çetta 54, KPH 90, 114) 'kobila, atkinja' < at.

ç) Me mbaresën *-icë* - < (sllav. -ica): *baxhi-cë* (KP Dashurie 87) 'grua që udhëheq punët e shtëpisë' < baçi; *hoxh-icë* 'hodžinica' < hoca; *budall-icë* (PP I 126) 'budalica' < budala.

Drejtëpërsëdrejti nga turqishtja në shqip, ka hyrë fjala *haxhuze* (Imami 28) 'grua e keqe' < tur. acuze < arab. ağüz 'plakë' (Kaleshi, 1970: 183-184).

II. Formimi i mbiemrave

Një grup i mbiemrave të gjuhës turke dhe arabe përdoret edhe në gjuhën shqipe pa kurrfarë ndajshese, psh., *hakik /i,e/* vërtetë, (Gjëegjëza 364), < tur. hakiki < arabisht haqiq; *batall*, i braktisur, i lënë pasdore, i prishur' < tur. batal < arab. battâl; *zavall-i*, mb. dhe sub. (Çetta 190, 141, Fj) 'i mjerë, i gjorë, fatkeq, fatzi' < tur. *zavalli*, *koxha* (Imami 22); *taze* (i freskët) tur. taze. Në këtë grup bën pjesë edhe një grup i mbiemrave të cilat shënojnë veçori të trupit të njeriut dhe që mund të jenë edhe si emra: psh: *sakaat*, *qor* < kör, *budall*, *ahmak* 'i marrë', *azgën* 'i tërbuar, i harbuar', tur. azgin; *tyrli* i *tyrli tyrli* 'i llojlojshëm' < tur. *türlü* dhe *türlü türlü*. (Kaleshi, 1970: 1985).

Sipas Kaleshit, një numër i madh i mbiemrave në gjuhën shqipe është formuar nga emrat e gjuhës turke dhe këtë në mënyra të ndryshme. Zakonisht me nyjën e përparme dhe prapashtesën *-shëm*, *-ëm*, *-të*.

1. Me nyjën e përparme dhe me prapashtesën *-shëm*; *i hatashëm* 'i tmerrshëm, i madh, i rrezikshëm' *türlü*, tur. hata; *i lezetshëm* *i lezeçëm* 'i ëmbël' < lezet; *i zorshëm* 'i rëndë, i mundueshëm, < tur. zor; *i rahatshëm* 'i lehtë, komfor' < tur. rahat; *i sakllaçëm* (PP I 227) dhe *i sagllamshëm* (K) 'i sigurt, i shëndetshëm' < sağlam.
2. Me nyjën e përparme dhe me prapashtesën *-të*: *i xhevahir-të*, (FJ, PP I 287) 'nga guri i çmueshëm' < tur. cevahir < arab. ğavâhir; *i bakër-të*; *i sagllamtë* 'i sigurt, i shëndosh' < sağlam; *i qelibartë* (Fj) 'nga qelibari' < tur. kahlibar < persisht kehruaba; *i shajaktë* 'nga shajaku' < tur. şayak; *i kadiftë* (Gjëegjëza 232), 'kadifen' < tur. kadife < arab. qatifa; *i xhamtë* (Fj) 'nga qelqi' < t. Cam; *i fildishtë* (Gjëegjëza 52) < fildişi.
3. Një numër i vogël i emrave formohet nga emrat e gjuhës turke me ndihmën e prapashtesave të gjuhës shqipe: me *-an*, bektashian (Fj) 'i bektashinje' < tur. beктаşi; me *-or* 'themelor' < tur. temel. Vëmendje të veçantë meritojnë mbiemrat e formuar nga mbiemrat e gjuhës turke si në shembujt e mësipërm me emrat: *i sari-të* 'i verdhë' tur. sari, *i tamamtë* 'i plotë' tur. tamam < arab. tāmām; *i hazërtë* 'i gatshëm' < tur. hazır < arab. hâdir; *i saktë* 'i saktë' i rregullt, i tërë' < sağ. (Kaleshi, 1970: 187).
4. Një numër i madh i mbiemrave përkatësisht i pjesoreve është nxjerrë nga foljet e gjuhës shqipe, të krijuara nga turqishtja, dhe nyjës së përparme të gjuhës shqipe me prapashtesë *-ur* (tosk.) *-un* (geg.): *i shaktisur*, *i shashtisur* 'i përhumbar, i hutuar' < me shashtisë < şaşirmak ose şaştırmak; *i ogradisur* (250 KPD 163) 'që ka rënë viktimë, aksidentuar', < shq. folja *me ogradisë* < osman.vj.: ogramak; *i sevdalisur* (PP I 218) 'i dashuruar, që ka rënë në sevda' < *me u sevdalisë* < tur. sevda; *i syrgynosur* (Fj) 'internuar, i përndjekur' <

me syrgynosë < tur.: sürgün; *i gjezdisur* (Fj) ‘që e ka parë botën’ shq. *me gjezdisë* < tur. bitmek; *i sèkëlldisur* ‘i përfunduar, i vrarë shpirtërisht, zemërthyer’ < *me u sèkëlldisë* < tur. sikilmek; *i sakatosur* ‘i gjymtuar’ < *me u sakatosë* < tur. sakatlamak; (Kaleshi, 1970: 185). Sipas Kaleshit, në fjalorin e shqiptarëve të Italisë ekziston edhe mbiemri: *i bitisur* (i,e,të) ‘finito²⁶’ < bitmek, taftisur ‘alienato, fissato’ < tur. tapmak²⁷. Nuk dihet se si kanë depërtuar deri te ata.

5. *Formimi i mbiemrave me prapashtesën –li*: Me këtë prapashtesë të gjuhës turke dhe nga emrat në gjuhën turke dhe ata në gjuhën shqipe formohen mbiemrat të cilët tregojnë ndonjë veçori: Disa janë trashëguar drejtpërsëdrejti nga turqishtja, por disa janë krijuar në gjuhën shqipe. Shembuj për përdorimin e kësaj prapashtese ka mjaft. Këtu po i japim vetëm disa prej tyre: *de(h)shetli* (K) ‘i fuqishëm, i dhunshëm’ < dehsetli; *dikatli* (K) ‘i kujdeshëm, pedant’ < tur. dikatli; *kuvetli* ‘i fuqishëm’ turl kuvvetli; *kabahatli* (Çetta, 51,112,161, 188, 211) ‘fajtor, i gabuar’ < t. kabahathli; *horosanli* ‘nga llaçi’ < tur. horosanlı; *sojli* (Fj.) sojleshë ‘nga soji i mirë’²⁸ < soylu; *kahreli* (Çetta 143), ‘mjerim, plot brenga’ < kahreli; synetli; (Xhuvani-Çabej 66) ‘i bërë synet’ < sünnetli; *rahmetli* (Imami 34) ‘i ndjerë’ < rahmetli. (Kaleshi, 1970 187-188). Gjithashtu mbiemri *zingerli* (KPH 161) dhe *zinxhirlu* (K), ‘i përbërë nga zinxhirët’ < zincirli; *sheqerli* (KPH 161), ‘i ëmbël, i ëmbëlsuar’ < şekerli; *rahmanli* (PP IV 607) ‘mëshirues, shpirtbutë, zemërbutë’ < tur. rahman < arab. rahmân. Kaleshi bën me dije se këta mbiemra janë formuar nga emrat e gjuhës arabe: rahmet-li, kimet-li, kahre-li. Për mbiemrin *rahmetli* konstaton se nuk e ka gjetur në fjalorët e turqishtes, dhe supozon se ndoshta është nga të folurit rumelian ose është krijuar në gjuhën shqipe. Fjala *harli* (Imami 57, 92, K) dhe hajërli (Çetta 82) ‘i lumtur’ hayirli përdoret si mbiemër, por edhe në kuptimin e mënyrës dëshirore *hajrli qoftë* < hayirli olsun! Por edhe si pasthirmë hajrli! < hayirli²⁹.
6. Kompozitat (fjalët e përbëra). – Një numër i madh i mbiemrave është përbërë nga emrat e gjuhës turke dhe mbiemrat e gjuhës shqipe. Këto kompozita mund të përdoren edhe si emra edhe si mbiemra të substantivuar, psh. *rrizkzi* (PP I 263) ‘fatzi’ < tur. rizk dhe shqip ‘i zi’; *baftzi* (f. *baftzezë*) (Fj) ‘fatkeq, i palumtur’ < tur. baht dhe shq. i zi; *baftmadh* ‘i lumtur’ < tur. baft dhe shq. i madh; *ogurzi* (Fj) ‘që ndjell të keqen, ndjellakeq/e’ < osmanvj. ogur dhe shq. i zi, kurse si sinonim përdoret edhe privativi në gjuhën turke ogursöz (fj), si në serbokroatishite ugursuz; *suratrumbullak* (KPH 81) ‘fytirërrumbullak’ < tur. surat ‘fytirë’ + shq. rumbullak; *bellollë* (Fj, Pren 134, 143 (Gjëegjëza 279) < tur. bel dhe shq. hollë; *sherrmadh* ‘ai që bën sherr, që grindet’ < tur. şerr+sh. madh, por edhe *sherrxhi* me të njëjtin kuptim. *gybekgjana* (Gjëegjëza 346) ‘barkmadh’ tur. göbek + alb. gjanë (i,e,të); *fustangier* (KPH 66) ‘fustan i gjerë’ < fistan+shq. gjërë.

Formimi i foljeve

1. Sipas Kaleshit, një numër i madh i foljeve është krijuar nga rrënja e foljeve të turqishtes, ose nga emrat prejfoljorë të gjuhës shqipe që kanë dalë, gjithashtu, nga foljet e gjuhës turke, psh., shq. *me konoshtisë* ‘flas, bisedoj’ u formua nga folja e gjuhës turke *konus* ose

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty.

²⁸ Është interesant se si sinonim për mbiemrin *sojli* ekziston edhe fjala ‘sojnik’ (Fj.) është nxjerrë nga prapashtesa sllave për formimin e *nomen actoris* – nik.

²⁹ Po aty.

nga emri prejfoljor i gjuhës shqipe *konushti* të cilën nuk e gjejmë në gjuhën turke, ose psh., *me ujdisë* nga rrënja foljore e turqishtes *-uy-* ose nga emri prejfoljor *ujdi*, *me gjezdisë* < tur. *gez-* ose *gjezdisë*, që, me sa duket, është formuar nga rrënja e kohës së kryer dhe foljes në gjuhën turke të vetës së tretë kur i shtohet prapashtesa *-isa*, psh.: *gez+di+isa*.

2. Ky lloj i formimit të foljeve është dukuri shumë e hershme në gjuhën shqipe sepse te Bardhi (1635) i gjejmë: *meu mascaruem* (145) ‘u bë për gaz/gazi i botës’ < tur. maskara; *me beghenisune* ‘pëlqej, gjej diçka që është e bukur’ < tur. beğenmek, kurse te Kavalioti (177) e gjejmë foljen *bojadis* (26), ‘ngjyros’ < boyamak; *hasmoj* (51) ‘urrej’ < tur. hasım; pastërmoj ‘kripas mishin’, < tur. pastırma; *shamatoj* (113), ‘bërtas, shaj’ < tur. şamata; *shastis* (89) ‘hutohem’ < tur. şaşmak; *ujdis* (113) ‘rregulloj’ < yumak³⁰.
3. Një grup mjaft të madh e përbëjnë foljet që janë formuar nga paskajorja e gjuhës shqipe dhe me mbaresën *-ue* me të cilën formohen foljet nga rrënja emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore: *me hazërue* (PP I 446) ‘përgatis’ < tur. hazır ‘gati’; *me rahatue* (Imami 23, KPH 141) ‘rregulloj, qetësoj’ < tur. rahat ‘paqe, rehati’ por e kemi edhe kuptimin e pësorës *me u rahatue* (Fj. PP I 262, Çetta 135, KPH 141) ‘qetësohem’; *me u saglamue* (Çetta 80) ‘sigurohem’ < tur. sağlam; *me u hallallue* (Çetta 76, 164) ‘bëj hallall, përsëndetem, hallashtisem’ < tur. helâl; *me hyqymue* (Çetta 76) ‘sundoj, qeveris’ < tur. hüküm ‘pushtet’; *me dystue* (Fj.) ‘rrafshoj’ < tur. düz; *me u çiftue* ‘bashkohem’ < tur. çift ‘çift’; *me çobanue* (Fj.) ‘ruaj delet’ < tur. çoban; *me hyqymue* (Pren. 123) ‘shëroj’ < 1. hekim; *me harxhue* (Fj. Pren. 118) ‘harxhoj, shpenzoj’ dhe *me u harxhue* (Asllani 45, K) ‘harxhohem’ < tur. harç; *me u serue* (Pren. 68) ‘krahasoj, rri në rresht’ < tur. sıra ‘rresht’; *me (u) sakatue* ‘sakatohem’ < tur. sakat, serb. ‘osakatiti (se); *me dertue* ‘vajtoj, ankohem për një gjendje të vështirë’ < tur. dert; *me ofkëllue* (PP II 77) ‘shpreh dhimbjen me pasthirmën “of” < tur. oflamak, edhe pse mund të interpretohet edhe në mënyrë onomatopeike; *me kaparue* por edhe *me kaparosë* (Fj) ‘jap kaparen, paradhënien’ serb. ‘kapisati’, < tur. caparo’ < it. caparra; *me u hamullue* ‘sulmoj dikë’ < tur. hamletmek < arab. haml; *me qorrue* dhe pësorja *me u qorrue* (Fj. Çetta 62) ‘verbëroj dikë dhe verbërohem’ < kör; *me t(h)emelue* ‘themeloj, bazoj’ < tur. temel; *me zaptue* (Fj. Pren 65) ‘pushtoj, zë, marr’ tur. zapt. Edhe pse kjo fjalë me origjinë arabe nuk ekziston në gjuhën turke vetëm, por vetëm me format e foljes zaptetmek. Mirëpo, sipas Kaleshit nga folja zaptetmek në gjuhën shqipe e kemi foljen ose neologjizmin *me ba zapt*. Pastaj: *me jallue* (Gjëgjëza 536) ‘vrapoj’, për të cilën Kaleshi supozon se është formuar nga pasthirmja *jalla* < tur. yallah < arab. vulg. jallah < arab. letrare já *Allâh* ‘O Zot’, përpara, pastaj *me u shamatue* (Fj) ‘grindem’ < tur. şamata; *me u saritue* (Fj) ‘vesh dy palë rroba’ < tur. çatal; *me çukurue* ‘mih, bëj gropë’ tur. çukur (Kaleshi, 1970: 189).
4. *Formimi i foljeve me formantin -is(ë)* – Në të gjitha gjuhët e Ballkanit paraqiten foljet të cilat janë formuar me mbaresën greke të së kryerës së thjeshtë (aoristit) –s, si psh., serb. *araksati*, *arnisati*, *đakonisati*, *metanisati* etj., siç këtë e ka konstatuar M. Vasmer³¹. Më vonë me formantin *-isa* është krijuar një sërë foljesh prejfoljore dhe prejemërore në të gjitha gjuhët e Ballkanit, madje edhe për formimin e foljeve nga fjalët me origjinë romane, psh., në serbisht *rezervisati*, *bagatelisati*. Ky formant foljor me siguri është njëri nga formantet më të shpeshta në gjuhën shqipe dhe ky në radhë të parë shërben për

³⁰ Po aty.

³¹ Max Vasmer, Die griechischen Lehnwörter im Serbo-Kroatischen, Berlin 1944.

formimin e foljeve nga foljet ose emrat e gjuhës turke. Kjo vlen edhe për formimin e foljeve nga fjalët turke në maqedonisht dhe serbisht. Në gjuhën shqipe paraqitet mbaresa e dyfishtë.³² *-is(ë)* dhe *-(d)is(ë)*. Foljet e këtij grupi formohen nga rrënja e zgjeruar e foljeve (refleksivi, faktitivi), qoftë nga rrënja e thjeshtë foljore, ose nga emri. Nga zgjerimi i rrënjës foljore, Kaleshi i thekson foljet: *me kurtalisë* (Çetta 88,134) dhe *me u kurtalisë* (K) ‘shpëtoj/shpëtohet’ < tur. kurtul-; *me jaratisë* (Gjëegjëza 209, KP Sk 163, PP II 570) ‘krijoj’ < tur. yarat-; *kopllais* dhe *kapllatis* (FJ) ‘vesh diçka, mbështjellë jorganin’ < kapla- i kaplat-; *dërdëlisë* (Fj.) ‘llomotit, dërdëlit’ < dırılda- : ose vetëm dırıldir-; *kullandris* (PP II 671 *kullandrejs*) si edhe *kolandis* (Fj) ‘përdor’ dırıld kullandir-; *hallallashtisë* (PP I 463) dhe *hallashtisë* (Çetta 177, 123, PP I 76) ‘përsëndetem me dikë, ia fal njëri tjetrit’ tur. helallaş-; *boshatis* (Fj) ‘zbraz’ dırıld tur. boşat-; *angllatisë* (Imami 87) – nga osmanvj. *ng*) i *anllatisë* ‘sqaroj dikujt’ dırıld anlat-; anlat-; *me azdisë* (Fj) i *hazdisë* (K) ‘tërbohet, merr forcë < azdır-. (Kaleshi, 1970: 190).

Nga rrënja e foljes së thjeshtë gjithashtu, kemi mjaft folje që janë formuar nga prapashtesa *-is(ë)*: *me batisë* ‘zhytem, fundosem’ < bat-; *me bitisë* (Gjëegjëza 111, Fj. PP I 325) ‘përfundoj, mbaroj’ < bit-; *me begenisë* pëlqej’ < beğenis ‘pëlqej’ < begen-; edhe pse ekziston edhe *me begendisë*, që është formuar me formantin *-di-*. Kaleshi vlerëson se mund të ndodhë që edhe forma *me begenisë* është formuar nga formanti *-di-*, vetëm që *d-*ja ka rënë, gjë që është dukuri normale në grupin *-nd* në gjuhën shqipe. Pastaj i kemi edhe shembujt *me bedisë* (PP I 333), por ndoshta edhe *me i bedite* ‘trilloj’ < arab. turq. bed’ etmek. Kaleshi thekson se nuk ka kurrfarë dyshimi se kjo folje mund të ketë të bëjë me foljen arabe ‘bād’ por në mënyrë analoge me një sërë rastesh të tjera, nga folja e përbërë e turqishtes bed’ etmek është dashur të pritet *me ba bed*, e jo *me bedite* ose *me bedisë*.³³

Sipas Kaleshit gjuha shqipe ka edhe një numër foljesh denominale që janë formuar nga emrat dhe mbiemrat me formantin *-is(ë)*: *batallis* (Fj.) ‘e bëj batal, e lë’ < turq. batal; *takamis* (Fj) ‘pajis’ tur. takim < arab. taqm; *tellalis* ‘telaliti, përhap kudo një lajm’ < telal: *dufeqisem* (Fj.) ‘gjuhëm me pushkë me dikë’ < tur. tüfek; *sapunis* (Fj.) ‘bëj me sapun, laj me sapun’ < tur sabun; *kallajis*, serb. ‘kalaisati’ < tur. kalay; *kashais* (Fj.) < tur. kaşağı, sepse sipas mendimit të Kaleshit nuk mund të ketë dalë nga folja kaşaklamak; *me synetisë* ‘sunetiti’ (syneti,) < tur. sünnet³⁴.

Si dëshmi se vërtet këtu bëhet fjalë për formantin grek, Kaleshi theksoi edhe disa folje me origjinë greke që përdoren në dialektin toskë, që janë nxjerrë në të njëjtën mënyrë si edhe shembujt e mësipërm të foljeve në gjuhën turke: *apofasis*, (PP I 292 292), vendos; *sillojisë* (PP I 452) ‘mendoj’.

5. *Formimi i foljeve me formantin -os(ë)* – Sipas Kaleshit, një numër i foljeve në gjuhën shqipe është formuar nge emrat dhe mbiemrat e gjuhës turke me formantin *-os(ë)*. Për origjinën e këtij formanti Kaleshi pajtohej me Çabejin i cili konstatoi se emrat e tillë janë nga greqishtja. Me rëndësi është të thuhet, sipas Kaleshit, se me këtë formant formohen vetëm foljet prejëmërore/denominale. Kaleshi shton se nuk ka hasur në asnjë rast në të cilin folja është formuar nga rrënja e foljes së thjeshtë ose foljes së zgjeruar çfarë ka qenë rasti me foljet me formantin *-is*. Për këtë dëshmojnë shembujt të cilët i ka dhënë Kaleshi: *me u merakos* (Fj) ‘brenqosem’ < tur merak; *me llafosë* (Gjëegjëza 286; PP I 189, 278, 323, FJ) ‘flas, bisedoj’ < tur. laf; *samaros* (Fj.) ‘vë samarin’ tur. samar; *katranos* (Fj.)

³² Po aty.

³³ Po aty.

³⁴ Po aty.

‘prish pahiri’ < tur. katran’, me një evoluim të shprehur kuptimor: *balsamos* (Fj) ‘balsamoj < tur. belesan; *damkos* (Fj) ‘damkos, e vunë në shtyllën e turpit’ e gozhduan në shtyllën e turpit’ < tur. damğa; *qefinos* (Gjëegjëza 537) ‘vesh me qefin të vdekurin’ < tur. kefin; *syrgjynos* (Fj) ‘dërgoj në mëgrim’ < tur. sürgom: *sheqeros* (Fj) ‘pošeceriti’ < tur. šeler: *me u qederos* < tur. keder; *me u inatos* (Fj) ‘inatiti se’, ‘inatosem, bëj për inat’ < tur. inat; *me kaparosë* < tur. kaparo < it. caparro; *me u matufosë* (Fj) ‘omatufiti’ < tur. matuf; *me u budallallosë* (Fj) ‘bëhem budalla, ‘budallallosem’ ’ < budalla; *me (u)sakatos* (Fj) ‘me sakatue dhe *me u sakatue* ‘sakatoj, gjymtoj’ ’ < sakat; *me u hallallosë* ‘përshëndetem me dikë, ia fal fajin dikujt’ ’ < helâl; *me u hardallos* (Fj) ‘tërbohem’ < tur. hardal.

6. *Formimi i foljeve me formantin -it(ë)* – Ekziston një numër shumë i vogël i foljeve prejemerore në gjuhën shqipe që janë formuar nga emrat dhe mbiemrat e gjuhës turke që janë formuar me formantin *-it(ë)* të gjuhës shqipe: *me harxhitë* (Gjëegjëza 535) ‘harxhoj’ < harç, krahas me formën *me harxhue*: *me çakëritë*, ‘zgurdulloj sytë’ < çakir; *me u hajzalitë* ‘bredh pa punë’ < haylaz; *me seritë* (KPH 157) < seyir; *me barabitë* (Fj) ‘krahasoj’ beraber; *me beditë* (PP II 94 – *Nji shqipe m’osht beditë e s’me len te baj cing a ming*) ‘paraqitet, krijohet’ < bed; ‘*me u zbudalitë* (PP II 78) *zbudalejtë*) ‘pobudaliti se’ < tur. budal, njësoj si në maqedonisht: ‘se zbudaliti’. (1970: 191)
7. *Formimi i foljeve me formantin -dis(ë)*. – Numri shumë më i madh i emrave formohen me mbaresën – di + formanti *-is(ë)*, dhe këtë në radhë të parë nga rrënja e foljeve në gjuhën turke. Është vështirë të pohohet me siguri për origjinën e mbaresës *-di/-ti*³⁵, por në bazë të gjitha gjasave ka të drejtë Shkalliqi kur konsideron se ky është vazhdim i perfektit të gjuhës turke *-di/-ti*³⁵. Nëse e marrim këtë si të vërtetë, atëherë, përderisa më lart Kaleshi ka theksuar se mbaresa *-isa* i shtohet rrënjës së thjeshtë të foljeve, këtu e kemi rastin kur *-is* i shtohet rrënjës perfekteve të gjuhës turke. Natyrisht, edhe këtu mund të merret parasysh rrënja e thjeshtë ose e zgjeruar foljore me mbaresat për faktitiv, reflektiv dhe pasiv, por i kemi edhe disa shembuj të rrënjëve denominale të nxjerra me formantin *-le/-la*. Kaleshi lidhur me këtë e thekson një numër të madh të shembujve së pari me rrënjë të zgjeruar e pastaj me rrënjë të thjeshtë foljore, sepse janë të rëndësishme jo vetëm për këtë temë, por edhe për dialektologji: *me batërdisë* (Fj), PP I 202), ‘shkatërroj, zhyt’ < bat+ir-, por gjithashtu *me batisë* < bat-; *me çallëstisë* (PP I 232) dhe *me çallëshstisë* ‘mundohem, punoj, mësoj < çal-iş-; *me u sèkëlldis* (Fj) mërzitem, idhnohem’ < sik+ıl_ ; *me kaplladis* (Fj) ‘tërheq jorganin < kaplat; *çakërdis* (Fj) ‘përhap andej-këndeje, e hutoj’, < çık+ar+t-(?); *rahatllandis*)PP II 96) – *rahatlandeëjs*) ‘qetësohem, rri lirshëm’ < rahat+la+n-; *konushstis* (PP I 448, PP 448, PP II 5710 *konushsteëjs*) ‘përshëndetem, bisedoj, < kon+uş-; *leqelendis* (PP I 448, PP II 571) ‘llangosem’ < leqe+le+n+; *zeherlendis* (PP II 21), por edhe *zeherlis* (K) ‘helmoj’ < zeher+le-; *xhezalladisë* (KPH 64), ‘dënoj’ < ceza+la+n_ ; < yar+at-; *me u çapërdisë* (PP II 56-ograshtejsë) ‘argëtohem’ < oğraş-; *kullandris* (PP I 70, 448) ‘përdor’ < kullan+dir-, por edhe *kullandejsë* (PP II 109); *bullundris* (PP IV 600) ‘rregulloj, pajis’ < bulun (?); *bojadis* ‘lyej me bojë, ngjyey’ < boyat-. (1970: 192)

Nga rrënja e foljeve të thjeshta numri i foljeve të formuara nga prapashtesa *-dis(ë)* është më i madh. Kaleshi thekson një numër të madh të foljeve dhe shton se nuk i ka numëruar të gjitha. Në mesin e tyre është folja *vardis* (Pren.10 K) ‘has, nuk i ndahem, i vihem me ngulm’ < var-; *inandis* (Gjëegjëza 407) ‘besoj, kam besim’ < iman-; *degdis* (PP I 242) ‘arrij, gjej’ < deg’; *shashtis* (PP II 66 *-shashteëjs*) dhe *shastis* (Fj, PP dhe 199) <

³⁵ Abdulah Škaljić, op. Cit. 42.

şaş-; *kandis* (PP I 384); ‘bind (em)’; < kan-; *uidise* (Imami 92, PP I 269, 333 Çeta 214, 195, 170, 263) ‘ndreq, qëllor’ < uy-; *kurdish* (KPSk 64, Imami 38, Asllani 69, PP I 209, Çetta 123, 178) ‘krijoj, kurdis’ < kur-, kurse me parashtesën ç- ekziston folja në gegërishte *çkurdisë* (Fj) ‘zhvidhos, labërtoj, e bëj më të çlirët’; *kaurdis* (Fj) dhe *kavërdis* (K) ‘bëj kaurdisjen’ < kavur-; *kërdise* (Fj Çetta 68, 16) ‘thyej, shkatërroj’ < bezdisë (Pren. 123, Fj K) ‘mërzis, bezdi’ < bez-, edhe pse sipas kuptimit do të duhej të jetë nga fjala bezdir- (në PP I 4444 shkruan *bezeris* që, sipas Kaleshit me siguri është nga fjala bezdir-) ; *bastis* (Çetta 81, 128, Fj. ‘bastis, kontrolloj’ < bas-; *taftis* (Fj) dhe *taptis* (K) ‘çmendem pas dikujt, e adhuroj dikë’ < tap-; *dalldis* (Fj, K) ‘çmendem për diçka’ < dal-; *sajdis* (Fj. PP II 51, 53) ‘vlerësoj, respektoj’ < say-; *ogradis* (Fj. K) ‘pësoj, kaloj keq’ < oğra-; *kondis* (KP Dasmë 163, PP II 37) ‘ndalem, strehoj, kaloj natën’ < kon-; *kandis* (Fj. K) ‘bind’ 163, PP II 37) < kan- kurse në gjuhën shqipe në të folurit e Kërçovës *kan(d)ej*s (njësoj edhe në KPH 129 , PP II 29, 37) ka kuptim reflektiv, psh., *kanejsa të shkoj* ‘pranova të shkoj’, kurse forma kalimtare formohet nga faktivi i turqishtes *kandërdisë* < kandır, psh, *më kandërdejsi* (më bindi); *braktis* (Fj. K), ‘lë, braktis’, < bırak-; *shashtisë* dhe *shastjejs*, (PP II 66, K) ‘hutohem, e humb kokën’ < tur. şaş-; *sardisë* (KPH 34) ‘rrethoj, qarkoj’ < sar-; *kazdis* (Çetta 232, 248- *Ati i Sulejman agës filloj me kazdis me kom*) ‘përmih, rrëmih, gropoj’ < kaz-; *këzdisë* (K) ‘zemëroj, idhnoj’ < kız: *gjezdis* (Fj. Çetta 45, Gjëgjëza 129) ‘shëtis’ < gez-; *çalldis* (loz) < çal-, kurse *çalltis* (PP I 236, II 123) ‘përpqem, mundohem, mësoj’, u krijua gjithsesi me kontraksion < *çallështisë* < çaliş-; *razgjeldis* (K) ‘tako’ < rast gel-; *qestis* (Fj) dhe *qesëndis* ‘shpotit, përqesh dikë’; *eglen(disë)* (K) dhe *enlenisë* (PP III 573) ‘argëtoj(hem)’ < eğlen-; *bejendisë* (Fj), *begenis*, *begenejs* (K) dhe *beqenis* (Çetta 36) ‘pëlqej’ < beğen-. Kaleshi ishte i mendimit se të gjitha këto fjalë e kanë origjinën nga turqishtja dhe ka shtuar në punim se megjithatë nuk kanë mundur të konstatojnë se konkretisht nga cilat fjalë turke e kanë origjinën. (Kaleshi, 1970: 191, 192).

Përfundime

Në këtë punim kemi vërejtur se mbaresën e gjuhës turke *-lu/lu; /li/lü/* e marrin disa mbiemra të gjuhës shqipe që kanë kuptim emëror dhe përdoren për emërtimin e personave ose prejardhjes së tyre si: *elbasanli, prizrenli, shehërli* ose që emërtojnë personat që kanë ndonjë gjë, si leje, profesion: *mejtepli, kryqali*. Me prapashtesën *-xhi*, kryesisht e formojnë shumësin emrat të cilët tregojnë profesione, nga emërtimet e të cilave janë formuar mbiemrat Mumxhiu, Duhaxhiu. Prapashtesa *-xhi* (tur. *-ci*) u shtohet fjalëve që përfundojnë me bashkëtingëllore të zëshme, kurse *-çi* bashkëtingëlloreve të pazëshme. Gjithashtu kemi konstatuar se disa fjalë janë formuar nga emrat e gjuhës turke si për shembull *haxhillëk* < haci; *pashallëk* < paşa, por disa edhe nga emrat në gjuhën shqipe, si *njerëzillëk* < shq. njerëz; *fshatar-llëk* < fshatar. Edhe numri i mbiemrave nga gjuha turke në gjuhën shqipe nuk është i vogël; *budallallëk* < tur. budalla ‘i marrë’ *ahmakllëk* < tur. ahmak ‘mendjeplogët, i mefshtë’. Poashtu disa mbiemra janë formuar nga mbiemrat në gjuhën shqipe: *sëmundëllëk* < shq. sëmundë; *pabesëllëk* < shq. (i.e, të) pabesë. Ky numër është i vogël. Në formimin e gjinisë femërore në gjuhën shqipe kanë ndikuar edhe mbaresat e gjuhëve sllave *-kë, -çkë, -ki* dhe *kinë* ose *kinja* dhe *-icë*. Numri i tyre nuk është i madh. Nuk kemi vërejtur që ndonjë emër e formon gjininë femërore me mbaresën-ë.

Gjithashtu kemi ardhur në përfundim se disa mbiemra përbëhen nga emri në gjuhën turke dhe mbiemri në gjuhën shqipe, si psh. *rrizkzi* (PP I 263) ‘fatzi’ < tur. rizk dhe shqip ‘i zi’; *baftzi* (f. *baftzezë*) (Fj) ‘fatkeq, i palumtur’ < tur. baht dhe shq. i zi;

Sipas Kaleshit, në të gjitha gjuhët e Ballkanit paraqiten foljet e formuara me mbaresën greke të së kryerës së thjeshtë (aoristit) –s, si psh., serb. *araksati, arnisati, ðakonisati, metanisati* etj., siç këtë e ka konstatuar M. Vasmer³⁶. Më vonë me formantin –isa është krijuar një sërë foljesh prejfoljore dhe prejemërore në të gjitha gjuhët e Ballkanit, madje edhe për formimin e foljeve nga fjalët me origjinë romane, psh., në serbisht *rezervisati, bagatelisati*. Ky formant foljor me siguri është njëri nga formantet më të shpeshta në gjuhën shqipe dhe ky në radhë të parë shërben për formimin e foljeve në gjuhën shqipe nga foljet ose emrat e gjuhës turke. Kjo vlen edhe për formimin e foljeve nga fjalët turke në maqedonisht dhe serbisht. Në gjuhën shqipe paraqitet mbaresa e dyfishtë: –(d)is(ë) dhe –dis.

Nga 129 folje që i kemi numëruar në këtë punim 17 folje janë formuar nga foljet në gjuhën shqipe dhe të cilat janë formuar nga emrat dhe mbiemrat në gjuhën turke dhe formantit –os(ë), 8 folje të gjuhës shqipe janë formuar nga emrat dhe mbiemrat e gjuhës turke dhe formantit –it(ë) dhe që e përmbajnë edhe mbaresën e aoristit të gjuhës greke –s, dhe 54 folje të gjuhës shqipe që janë formuar nga rrënja e foljeve në gjuhën turke dhe formantit –(d)is(ë), si për shembull *batërdisë, çakërdisë, kaplladisë, çallëstisë, sëkëlldisë* ose *inandisë* etj.

Shkurtesat:

arab. = arabisht

mb. = mbiemër

shq. = shqip

Asllani = Ali Asllani, *Hanko Halla dhe vjersha të zgjedhura*, Beograd 1963

Bardhi = F. Blanchus, *Dictionarium latino-epiroticum*, Roma, 1635. Botim M. Roques, *Le dictionnaire albanais de 1935*, Paris 1932.

Çetta = Anton Çetta, *Tregime popullore I*, Drenicë, Bleni i parë, Rilindja, Prishtinë, 1963.

250 KP dasme = *Këngë popullore dasme*, Instituti i folklorit, Tiranës, 1966.

f. = femininum, gjinia femerore.

Fj. = *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë 1954.

greq. = greqisht

Gjëegjëza = *Folklori shqiptar, Gjëegjëza*, Universiteti shtetërori Tiranës, Tiranë 1968.

Imami = Sitki Imami, *Drejt ditëve të reja*, Rilindja, Prishtinë 1964.

It. = italisht

K= Hasan Kaleshi, materiali i mbledhur nga të folurit e shqiptarëve në rrethinën e Kërçovës si edhe turqizmat e shënuar në Kosovë, sidomos në Podujevë.

KP dashurie = *Këngë popullore Dashurie*, Instituti i folklorit, Tiranë, m 1965.

KPH = *Këngë popullore historike (1878-1912)*, Tiranë 1962,

KPSk = *Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun*, Tiranë 1967.

Pren. = V. Prennushi, *Kangë popullore gegnishte*, Sarajevë, 1911.

PP I-IV = *Folklori shqiptar I, Proza popullore*, Vëllimi I-IV, Tiranë 1963-1966.

tur. = turqisht

³⁶ Max Vasmer, *Die griechischen Lehnwörter im Serbo-Kroatischen*, Berlin 1944.

Referencat:

- [1]. ë1.] Asllani, A: (1963) *Hanko Halla dhe vjersha të zgjedhura*, Beograd
- [2]. ë2.] Bardhi, F: (1635): *Dictionarium latino-epiroticum*, Roma, Botimi M. Roques, Le dictionnaire albanais de 1935, Paris 1932.
- [3]. ë3.] Çetta, A: (1963) *Tregime popullore I*, Drenicë, Bleni i parë, Rilindja, Prishtinë
- [4]. ë4.] Ciordano, E: (1963) *Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë*, Eizioni Paoline, Bari.
- [5]. ë5.] Dizdari, T: (2005) *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë
- [6]. ë6.] Kostaq, C & Çabej, E dhe etj: (1954) *Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë*
- [7]. ë7.] ë1968] *Folklori shqiptar, Gjëegjëza*, Universiteti shtetëror i Tiranës, Tiranë
- [8]. ë8.] Imami, S: (1964) *Drejt ditëve të reja*, Rilindja, Prishtinë
- [9]. ë9.] Kaleshi, H: (1970) *Turski uticaji u tvorbi reči u albanskom jeziku*, Izdanje Filološkog fakulteta u Prištini, Priština
- [10]. ë10] Prennushi, V: (1911) *Kangë popullore gegnishte*, Sarajevë, 1911

Literatura shtesë:

- [1]. *Këngë popullore dasme*, Instituti i folklorit, Tiranë, 1966
- [2]. *Këngë popullore Dashurie*, Instituti i folklorit, Tiranë, 1965
- [3]. *Këngë popullore historike (1878-1912)*, Tiranë 1962
- [4]. *Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun*, Tiranë 1967
- [5]. *Fjalët turkishte në "Lahutën e Fishtës, Shejzat 3-4 (1961)*, Romë, 1961
- [6]. *Folklori shqiptar I, Proza popullore, Vëllimi I-IV*, Tiranë 1963-1966